

*D. 4. Parlamentit
Te bales per fjal
për të cilin po lexon
olbe të fjalës mund
në rolet për nistat*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ 2019

RELACION

PËR PROJEKTREZOLUTËN

“PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ANËTARËSIMIN NË BASHKIMIN EUROPIAN”

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë si dhe të ligjit nr 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” po paraqesim Projekt-rezolutën “Për çeljen e negociatave të Republikës së Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian”.

Duke marrë paraqysh raportin e fundit të Komisionit Evropian i publikuar me datë 29.05.2019 për Shqipërinë, rekomandimet e tij, duke patur parasysh përparësitë e vendosura nga Komisioni Evropian si parakusht për çeljen e negociatave, si dhe duke marrë parasysh që në tetor do të mbahet takimi i lartë i Këshillit Evropian i cili do të vendosë mbi propozimin e Komisionit Evropian për çeljen e negociatave për anëtarësim me vendet candidate, Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut, konsiderohet e rëndësishme që Kuvendi të vijojë me intensitet punën e tij në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Kushtetuta, Rregullorja e tij si dhe ligjet në fuqi përsa I përket në veçanti procesit të integritimit në Bashkimin Evropian.

Përparësitë janë: reforma në drejtësi; administrata publike; lufta kundër korrupsionit; lufta kundër krimit të organizuar si dhe të drejtat e njeriut.

Po ashtu, në një rend demokratik, i cili udhëhiqet nga parime dhe institucione demokratike, vend të veçantë zë edhe reforma zgjedhore.

Duke iu referuar raportit të fundit të OSBE/ODIHR dhe rekomandimeve të tij, reforma zgjedhore merr një rëndësi të posaçme si pararendese e të gjitha reformave të tjera, ku e drejta e votës është guri themeltar i një sistemi demokratik.

Sikurse raportet ndërkombëtare e konstatojnë në vazhdimësi, Shqipëria ndodhet në një krizë përfaqësimi e cila po sjell pengesa në ngritjen dhe ripërtëritjen e institucioneve kushtetuese dhe të krijuara me ligj.

Prandaj me anë të kësaj projektrezolute kërkohet që institucionet shqiptare, bazuar në parimet demokratike, në institucionet demokratike dhe me një përfaqësim të ligjshëm të vijojë e përqëndruar në reformat e ndërmarra dhe t’i përfundojë ato në respektim të kuadrit kushtetues e

ligjor në fuqi, duke bërë të mundur rezultate konkrete në zbatimin e përparësive të vendosura nga Komisioni European për çeljen e negociatave deri në anëtarësimin me të drejta të plota në Bashkimin European.


Projektrezoluta i drejtohet gjithashtu edhe shteteve anëtare të Bashkimit European në kuadër të *Summit*-it të ardhshëm të Këshillit European i cili do të mbahet me datat 17-18 tetor 2019, ku një ndër pikat e diskutimit në rendin e ditës do të jenë edhe vendimet për çeljen e negociatave me Republikën e Shqipërisë dhe me Republikën e Maqedonisë së Veirut.

Në kuadër të kësaj prespektive, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë duhet të angazhohet më tej për ecurinë e reformave dhe zbatimin e tij sipas funksioneve që Kushtetuta dhe ligjet në fuqi i kanë caktuar.

Përsa më sipër kërkohet që të fillojë procedura e shqyrtimit dhe miratimit të kësaj projektrezolute, bashkëngjitur relacionit shpjegues.

Propozues

RUDINA HAJDARI



SENIDA MESI

